

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i pergjithshem penal, me gjyqtarin gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuareve B. H., O. H. dhe F. H. që te gjithë nga fsh. KK Prizren, për shkak të veprës penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 par.1 p.1.4 të KP-së, dhe vepra penale te sulmit nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 te KP-se, sipas aktakuzes PP.nr.1365-4/16 të dt.21.07.2016, duke vendosur lidhur me kërkesën nga ana e PTH-re, për dhënjen e urdhërit ndëshkimor, me dt. **26.11.2018** merr këtë:

AKTGJYKIM

Te akuzuarit:

1.B. H. nga i ati R. e ema F. i lindur me dt.24.01.1994 ne Prizren, tani jeton ne fsh. KK Prizren, student, shkollen e mesme te kryer, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

2.O. H. nga i ati R., e ema H. e vajzerise E. i lindur me dt.10.05.1971 ne fsh. KK Prizren ku edhe tani jeton, shkollen fillore te kryer, menagjer NT", i martuar, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

3.F. H. nga i ati R. e ema H. e vajzerise E. i lindur me dt.14.12.1978 ne Prizren, tani jeton ne fsh. KK Prizren, shkollen e mesme te kryer, punetor NT", i martuar, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

JANË FAJTOR

I akuzuari B. H.

1.Se me dt.23.04.2016 rreth ores 22,40 min, ne Prizren ne rr. , perball stacionit policor, i shkaktone lendime trupore dhe perkohsisht ia demton shendetin e te demtuarit P. T. ne ate menyre qe derisa dilnin nga stacioni policor ku kishin qene te involvuar per prishje te rendit dhe qetesise publike, sipas rastit fillimisht provokohen me njeri tjeterin verbalisht, ku i demtuari i drejtohet me fjalet:"qka po kqyr shtremt, a pse ta kam rreh baben a", dhe momentin kur hyne ne automjet i demtuari, i pandehuri e hap deren e automjetit, e godet me grusht ne regjionin e fytyres,me qrast me keto veprime i shkakton lendime te lehta trupore, lendime keto me afer te konstatuara ne mendimin e ekspertit mjeko ligjor dr.M. G. te dt.26.06.2016,

-me keto veprime kryen veprën penale te lendimit te lehte trupor nga neni 188 par.1 p.1.4 të KP-së.

Te akuzuarit O. H. e F. H.

2. Me date, kohe dhe vend te njejte si ne dispozitivin nen 1 te kesaj aktakuze, ne bashkeveprim, me dashje perdorin forcen ndaj te demtuarit E T ne ate menyre kur i demtuari Parim e goditet nga B. H E del nga automjeti per ti ofruar ndihme vellaut te tije, por sulmohet nga te pandehurit ne pjese te ndryshme te trupit por nuk i shkaktojne lendime te dukshme trupore.

-me keto veprime kryejne veprën penale te sulmit nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Andaj gjykata me aplikimin e dispozitave te nenit 4, 41, 43 par.1 pika 1.3, nenit 46, 73 te KPK-es dhe nenit 495 te KPPK-ës jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

PRANOHET, kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr. 1365-4/16 të dt. 21.07.2016, ashtu që,

Te akuzuarit B H i shqiptohet

DËNIMI ME GJOBË

Si ne dispozitivin nne 1 te kesaj aktakuze, në lartësi prej **200 Euro**, të cilën shumë i dënimit me gjobë i akuzuari është i obliguar ta paguaj, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi i shqiptuar me gjobë do te zëvendësohet me denim burgimi duke llogaritur per çdo **20 Euro** nje ditë burg, rrespektivisht 10 dite burgim.

Te akuzuarit O H i shqiptohet

DËNIMI ME GJOBË

Si ne dispozitivin nen 2 te kesaj aktakuze, në lartësi prej **200 Euro**, të cilën shumë i dënimit me gjobë i akuzuari është i obliguar ta paguaj, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi i shqiptuar me gjobë do te zëvendësohet me denim burgimi duke llogaritur per çdo **20 Euro** nje ditë burg, rrespektivisht 10 dite burgim.

Te akuzuarit F H i shqiptohet

DËNIMI ME GJOBË

Si ne dispozitivin nen 2 te kesaj aktakuze, në lartësi prej **200 Euro**, të cilën shumë i dënimit me gjobë i akuzuari është i obliguar ta paguaj, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi i shqiptuar me gjobë do te

zëvendësohet me denim burgimi duke llogaritur për çdo 20 Euro një ditë burg, rrespektivisht 10 dite burgim.

Obligohen të akuzuarit kësaj gjykate që ti paguaje të gjitha shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të ekspertizës mjeko ligjor në mënyrë solidare shumen prej 20,00 Euro, paushallin gjyqësor secili veq e veq me nga 30 Euro, si dhe në emër të kompenzimit për viktimat e krimit secili veq e veq shumen me nga 30 euro, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari Parim e E. R. T. nga Prizren rr. nr.4, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në kontest të rregullt civilo-juridik.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzë PP.nr.1365-4/16 të dt. 21.07.2016, me propozim që pa e mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në bazë të provave të besueshme të cilët gjenden në shkresat e lëndës të lëshoj urdhërin ndëshkimorë kundër të akuzuarëve B. H. O. H. e F. H. që të gjithë nga fsh. KK Prizren, për shkak të veprës penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par.1 p.1.4 të KP-së, dhe veprës penale të sulmit nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KP-se, dhe të njëjtit t'i shqiptohet dënimi me gjobë i paraparë me ligj.

Gjyqtari gjykues me rastin e shqyrtimit të kërkesës të PTH-re në Prizren për dhënjen e urdhërit ndëshkimor konstatoi se ka të dhëna të mjaftueshme të cilat ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënjen e urdhërit ndëshkimor, andaj gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore dhe morri vendim që ta pranoj propozimin për dhënjen e urdhërit ndëshkimor PP.nr. 1365-4/2016 të dt. 21.07.2016, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë deklarata e të dëmtuarëve P. T. dhe E. T. të dhëna në stacionin policor në Prizren me dt.23.04.2016, deklarata e të pandehurëve Blend Hogja, O. H. dhe F. H. të dhëna pranë stacionit policor në Prizren me dt.23.04.2016, raporti mjekësor me nr.3209 dhe 3210 të spitalit regional në Prizren, të dr.K. K. të dt.24.04.2016, mendimi i ekspertizës mjeko ligjore të dr.M. G. të dt.26.06.2016, të cilat i bashkangjiten shkresave të lëndës ku vërtetohet se të akuzuarit kanë kryer vepra penale e cila i vihet në barrë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u muarr në bazë të nenit 450 dhe 451 par.1 të KPPK-ës.

Me sa u tha më lartë u vendos si në shqiptim të dispozitivit të këtij aktgjykimi,

4

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1571/2016 të dt.26.11.2018

Sekretare Juridike
Fatime Bajraktari

Gjyqtari
Fatmir Krasniqi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditëve, nga dita e pranimet në këtë gjykatë. Po qe se i akuzuari nuk ushtron kundërshtim në afatin e paraparë ligjorë, aktgjykimi merr formën e prerë.